

VENDIM
Nr. 364, datë 6.5.2020

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 100% TË AKSIONEVE TË
SHOQËRISË “TRAJTIMI I STUDENTËVE”, SH.A., ELBASAN, NGA MINISTRIA
E FINANCave DHE EKONOMISË TE BASHKIA ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Trajtimi i studentëve”, sh.a., Elbasan, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Elbasan, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama